



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.02.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:21 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 9. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 4. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
- 5. Arben Lila, përfaqësues i EU4Justice (në sallë).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 7. {...}, përfaqësues i ILD-së.*
- 8. Mimoza Koçiu, këshilltare për komunikimin dhe median në kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- 9. Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).*

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Fillimisht ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ende është në një takim zyrtar me të huaj dhe për shkak të mospërfundimit të këtij takimi mbledhja do të drejtohet nga ana ime Ilir Rusi, si zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për këtë arsye mbledhja po fillon në këtë orë dhe jo në orën që ishte shpallur, ora 12:00.

Sipas rendit të ditës, pika e parë e këtij rendi dite ka të bëjë me zhvillimin e

seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Sipas autorizimit nr. {...} prot., datë 15.02.2024, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është autorizuar zoti {...} me detyrë inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili do të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor në ngarkim të magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, që do të zhvillohet në Këshillin e Lartë Gjyqësor në seancën e datës 15.02.2024, ora 12:00.

Ndërkohë që edhe magjistratja znj. {...} është njoftuar për këtë seancë dëgjimore, por në kohë ka paraqitur një kërkesë për shtyrje.

Ftoj administratën të bëjë me dije përfaqësuesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

(Futet në sallën e mbledhjes z. {...}, përfaqësues i ILD-së.)

Ilir Rusi: Në vijim të këtij procedimi disiplinor, është paraqitur z. {...} i cili është pajisur me autorizimin përkatës nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me detyrë inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili do të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor në ngarkim të magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, që do të zhvillohet në Këshillin e Lartë Gjyqësor në seancën e datës 15.02.2024, ora 12:00. Autorizimi përmban numrin {...}, datë 15.02.2024.

Ndërkohë, magjistratja znj. {...} ka marrë dijeni për këtë seancë dëgjimore, por në datën 8 shkurt ka bërë kërkesën, 9 shkurt është protokolluar, kërkesa e saj për shtyrje.

Për më tej, në përmbajtje të saj, fjalën po ia jap relatorit për të lexuar fabulën e kërkesës për shtyrje.

Gentiana Muçaj: Më datë 9.02.2024, protokolluar pranë Këshillit me nr. {...} prot., është paraqitur kërkesa për shtyrje e znj. {...}, të kësaj seancë dëgjimore, për shkak

se nga data 15.02.2024 deri më datë 19.02.2024, ndodhet në një udhëtim jashtë shtetit, në Bruksel, dhe bashkangjitur kërkesës ka paraqitur biletat dhe prenotimin e hotelit. Dje më datën 14.02.2024, me nr. prot. {...} është paraqitur si provë komunikimi me agjencinë turistike, e cila nuk mund të shtynte dot biletën për të qenë prezent.

Në këto kushte ka një shkak që nuk është paraqitur në këtë seancë dëgjimore.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Muçaj!

Ftoj përfaqësuesin e Inspektorit (ILD-së) për të shprehur opinionin e tij në lidhje me këtë kërkesë të bërë nga magjistratja {...}.

{...}: Faleminderit!

Meqenëse magjistratja subjekt procedimi disiplinor, në pamundësi objektive nuk është paraqitur sot në seancë dëgjimore, referuar arsyeve që u relatuan, mbi kërkesën që ka paraqitur për shtyrje seance, mendoj që t'i jepet mundësia të paraqitet në një seancë tjetër, në një datë dhe orë të caktuar, siç do të vlerësohet nga Këshilli.

Ilir Rusi: Faleminderit z. {...}!

Ju ftoj të largoheni me qëllim që Këshilli të diskutojë mbi këtë kërkesë dhe pastaj t'ju komunikojë vendimmarrjen përkatëse.

(Largohen nga salla e mbledhjes z. {...}, përfaqësues i ILD-së si dhe palë të tjera të pranishme në sallë.)

Ilir Rusi: Në vijim të shqyrtimit të kësaj pike të këtij rendi dite, ftoj anëtarët nëse kanë diskutime për sa u parashtrua nga relatorja dhe nga përfaqësuesi i ILD-së për vijimin e këtij procedimi disiplinor.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj relatoren për të propozuar datën dhe orën.

Gentiana Muçaj: Atëherë, me qëllim që t'i japim mundësinë zonjës {...} të jetë

në seancë dëgjimore, unë propozoj që të shtyhet seanca dhe të bëhet e mundur prezenca e saj në seancë dëgjimore. Ajo nga data 15 – 19 shkurt nuk është, ndodhet në {...}, kështu që data në varësi të kalendarit të mbledhjeve.

(Anëtarët diskutojnë për datën dhe orën e seancës dëgjimore të radhës.)

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të këtij procedimi, ftoj përsëri relatoren për të perifrastuar propozimin, duke përfshirë edhe datën dhe orën që propozon mbi mbajtjen e seancës dëgjimore.

Gentiana Muçaj: Atëherë unë propozoj që seanca e ardhshme dëgjimore të caktohet në datën 29 shkurt, ora 11:00, pasi është kohë e mjaftueshme që t'i jepet mundësia dhe të paraqesë pretendimet e veta.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Muçaj!

Ka diskutime për sa u propozua?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime, hedhim në votim propozimin e znj. Muçaj mbi shtyrjen e kësaj seance dëgjimore, në lidhje me këtë procedim disiplinor ndaj magjistrates {...}.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Për të mos përsëritur dy herë vendimin, ftoj përfaqësuesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për t'i komunikuar vendimin.

(Futen në sallën e mbledhjes z. {...}, përfaqësues i ILD-së si dhe palë të tjera të pranishme në sallë.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.02.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, viti 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm (relatore znj. Irena Plaku).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:21 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta sipas rendit të ditës.

8. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
4. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
5. *Arben Lila, përfaqësues i EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, viti 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm (relatore znj. Irena Plaku).

Ilir Rusi: Në vijim të këtij rendi dite, si pikë dy e saj është përcaktuar zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe seanca është parashikuar të mbahet sot në orën 13:00. Meqenëse pika e parë përfundoi në një kohë më të shpejtë për shkak të shtyrjes, dhe nuk pati diskutime, atëherë për efektivitet të kohës,

do t'i propozoja Këshillit të Lartë Gjyqësor që ne të vazhdojmë me shqyrtimin e pikëve të tjera të rendit të ditës dhe në momentin kur të vijë ora përkatëse të vazhdojmë me shqyrtimin e kësaj pike. Jeni dakord?

Irena Plaku: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën tre të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, viti 2023”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Përkohshëm. Për më tej fjalën relatores znj. Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Po ju shtroj raportin vjetor mbi veprimtarinë e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, viti 2023.

Komisioni i Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari (KPSHA), për vitin kalendarik 2023 (KPSHA), është ngritur dhe ka ushtruar veprimtarinë e tij bazuar në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenet 62, 66-69 të këtij ligji, si dhe në Rregulloren “Për organizimin dhe

funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ...”, miratuar me vendimin nr. 200, datë 11.06.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me vendimin nr. 34, datë 19.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u vendos përbërja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve ... i përbërë nga: 1. Z. Ilir Rusi – anëtar; 2. Z. Alban Toro – anëtar; 3. Znj. Irena Plaku – anëtar. Anëtarë zëvendësues të këtij Komisioni të Përkohshëm janë: 1. Znj. Yllka Rupa – anëtar; 2. Z. Klodian Kurushi – anëtar.

Gjatë vitit 2023, në Këshill rezultojnë të jenë depozituar 99 ankesa të reja kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari. Nga këto 99 ankesa, Komisioni ka trajtuar 74 prej tyre me vendim Komisioni (ku për 73 ankesa është vendosur refuzimi i ankimit, ndërsa për 1 ankesë është vendosur pushimi i ankimit); për 1 ankesë është vendosur me vendim relatori mospranim ankimi; ndërsa 1 ankesë i është dërguar për kompetencë organit kompetent; ndërsa 23 ankesa për të cilat nuk u bë e mundur shortimi dhe trajtimi i tyre për shkak të kohës së kufizuar, i janë mbartur Komisionit të ri, për sa kohë që Komisioni e ushtron veprimtarinë deri më 31 dhjetor 2023.

Përveç 99 ankesave të regjistruara rishtazi gjatë vitit 2023, Komisioni ka pasur për të trajtuar edhe 10 ankesa të mbartura nga viti 2022 dhe 1 ankesë të mbartur nga vit 2021, duke e çuar në 110 numrin total të ankesave që duheshin trajtuar gjatë vitit 2023.

Në lidhje me 10 ankesat e mbartura nga viti 2022 rezultojnë që të gjitha këto ankesa janë trajtuar me vendim Komisioni dhe për to është vendosur refuzimi i ankimit. Ndërsa ankesa e mbartur nga viti 2021 ka ngelur pa u trajtuar dhe si rrjedhojë kjo ankesë i është mbartur Komisionit të ri. Në lidhje me këtë ankesë të mbartur nga viti 2021 rezultojnë se është regjistruar pranë KLGJ-së në dhjetor të 2021 dhe nuk u arrit të trajtohej nga Komisioni i vitit 2021 dhe nga Komisioni i vitit 2023.

Sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se gjatë vitit 2023 janë grumbulluar gjithsej 110 ankesa (10 të mbartura nga viti 2022; 1 e mbartur nga viti 2021 dhe 99 të regjistruara në viti 2023). Komisioni gjatë vitit 2023 ka zhvilluar 11 mbledhje në të cilat ka trajtuar 84 ankesa (10 nga viti 2022 vendosur refuzimi + 74 nga viti 2023 ku

për 73 ankesa vendosur refuzimi, ndërsa për 1 ankesë vendosur pushimi i ankimit); për 1 ankesë (e regjistruar gjatë vitit 2023) është marrë vendim mospranim ankimi nga relatori; 1 ankesë (e regjistruar gjatë vitit 2023) është dërguar për kompetencë organit kompetent; si dhe 24 ankesa (23 të regjistruara gjatë vitit 2023 dhe 1 e regjistruar gjatë vitit 2021) kanë ngelur pa u trajtuar duke iu mbartur në këtë mënyrë Komisionit të ri të krijuar tashmë në vitin 2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, viti 2023”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një gjyqtari, viti 2023”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.02.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).²

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

² Këto çështje ishte parashikuar të trajtoheshin e 4-ta, e 5-ta, e 6-ta, e 7-ta, e 8-ta sipas rendit të ditës. 13

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:21 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Emona Muçi | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Irena Plaku | (anëtare) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj.***

Naureda Llagami.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashitë.*
- 2. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 4. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
- 5. Arben Lila, përfaqësues i EU4Justice (në sallë).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 7. Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 4 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, meqenëse kërkesa që është renditur në rendin e ditës nr. 4, nr. 5, nr. 6., nr. 7 dhe nr. 8 (*bëhet fjalë për çështjet e renditura sipas rendit të shpërndarë*) kanë të njëjtin objekt dhe bën fjalë për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në gjykatat përkatëse ku kandidatët fillimisht kanë shprehur pëlqimin dhe kanë paraqitur kërkesat e tyre, nëse kolegët bien dakord, unë po e relatoj në mënyrë të përmbledhur objektin e përbashkët të të gjithë këtyre kërkesave, ku përfundimi i projektvendimit është i njëjtë për secilin: Përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë për shkak të tërheqjes së kërkesave.

Jeni dakord?

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u propozua?

(Nuk ka diskutime)

Meqenëse nuk ka diskutime, hedhim në votim propozimin e zotit Kurushi.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Sipas kësaj vendimmarrjeje të tanishme të Këshillit, pika 4, 5, 6, 7 dhe 8 e kësaj mbledhjeje, do të prezantohen me një relacion dhe pastaj në një moment të dytë do të kalojmë në votim të veçuar për secilin magjistrat.

Fjala për ju zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Në mënyrë të përmbledhur unë po parashtoj relacionet që i kemi përgatitur për secilin nga kandidatët dhe që i është vënë në dispozicion secilit anëtar.

Parashtrimin po e bëj në mënyrë të përmbledhur pasi objekti është i përbashkët.

Zonja {...}.

Ka paraqitur interesin e saj me kërkesën e bërë për pozicionin e hapur me vendimin e KLGJ-së nr.499, datë 21.11.2022, për një pozicion të lirë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Më pas ajo ka paraqitur një kërkesë tërheqjeje nga ky kandidim.

Po për të njëjtin pozicion nr.499, datë 21.11.2022 fillimisht ka paraqitur interes me kërkesën e bërë znj. {...}. Më pas kandidatja ka paraqitur një kërkesë për t'u tërhequr

nga kandidimi në lidhje me pozicionin nr. 499.

Më tej, po në të njëjtën ditë që është shpallur me vendim të KLGJ-së, pra datë 21.11.2022 KLGJ ka shpallur me vendim hapjen e një vendi vakant të përhershëm me nr. 504, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në lidhje me këtë pozicion të shpallur nga KLGJ-ja, ka paraqitur interes zonja {...}. Më pas, në vijim të procedurave të verifikimit, zonja {...} ka tërhequr kërkesën për pozicionin e shpallur nga KLGJ-ja me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022.

Për pozicionin e shpallur me vendimin e Këshillit në po të njëjtën datë, datë 21.11.2022, me vendimin nr. 502 është hapur një vend i lirë në fushën e së drejtës penale, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në lidhje me këtë pozicion ka shfaqur interes dhe ka paraqitur kërkesë kandidatja zonja {...}. Më tej, gjatë verifikimit në këtë procedurë, edhe kjo kandidate ka paraqitur kërkesë ku tërheq kërkesën e parë të paraqitur prej saj për pozicionin nr. 502 të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin e datës 21.11.2022.

Së fundmi, po për të njëjtin pozicion, me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për pozicionin e lirë në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën e së drejtës penale, ka paraqitur kërkesë zoti {...}. Më tej zoti {...} ka tërhequr kërkesën e paraqitur për këtë pozicion.

Kështu që, të gjithë këta kandidatë, meqenëse kanë një objekt të përbashkët që është tërheqja e kërkesave të tyre nga pozicionet e cituara më sipër nga ana ime, pra 499, 504 dhe 502, të shpallura me vendimin e KLGJ-së datë 21.11.2022, është vendi që në këtë rast ne të procedojmë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për secilin nga kandidatët që kanë tërhequr kërkesat e tyre.

Ndodhur në këto kushte unë paraqes fillimisht projektvendimin, duke marrë për bazë rendin e përcaktuar në mbledhjen e sotme, fillimisht për kandidaten znj. {...} dhe i propozoj Këshillit në këtë rast që të vendosë:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për

kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime)

Atëherë hedhim në votim projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, projektvendim i cili ka lidhje me pikën 4 të këtij rendi dite.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Për më tej fjalën z. Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Në lidhje me kërkesën për heqje dorë nga kandidimi të paraqitur nga zonja {...} për pozicionin nr. 499, datë 21.11.2022 të paraqitur në Këshillin e Lartë Gjyqësor më datë 14.06.2023 prej saj, ne propozojmë:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit që ka të bëjë me “Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, projektvendim i cili ka lidhje me pikën 5 të këtij rendi dite.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1.Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Në lidhje me kërkesën për heqje dorë nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë si gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, të KLGJ-së, kërkesë e paraqitur më datë 14.06.2023 nga kandidatja znj. {...}, ne propozojmë si Komision:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, projektvendim i cili ka lidhje me pikën 6 të këtij rendi dite.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, , për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Në lidhje me kërkesën për heqje dorë të paraqitur nga kandidatja zonja {...} për kandidimin e saj në një pozicion të lirë të shpallur nga KLGJ me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kërkesë e paraqitur në KLGJ më datë 14.06.2023, Komisioni i propozon Këshillit që të vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të

Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, projektvendim i cili ka lidhje me pikën 7 të këtij rendi dite.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Për më tej fjala sërish për relatorin z. Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Kërkesa e radhës ka pasur për objekt heqjen dorë nga kandidimi për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022 të KLGJ-së për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, kërkesë e paraqitur nga kandidati z. {...}, e cila është depozituar në KLGJ më datë 05.06.2023. Në lidhje me këtë kërkesë të paraqitur ne i propozojmë KLGJ-së si Komision:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”, projektvendim i cili ka lidhje me pikën 8 të këtij rendi dite.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pikat 3, 4, 5, 6, 7 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.02.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).³

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:21 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Emona Muçi | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Irena Plaku | (anëtare) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Gentiana Muçaj | (anëtare) |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 9-ta sipas rendit të ditës.

9. Markelian Koça (anëtar)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

4. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.

5. Arben Lila, përfaqësues i EU4Justice (në sallë).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Për më tej, vazhdojmë me pikën 9 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Relacioni i radhës shoqëron projektvendimin që ka për objekt hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë. Bashkëlidhur janë edhe disa akte që lidhen me kandidatët të cilët duhet t'i plotësojnë, siç janë “vetëdeklarimi për situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe “vetëdeklarimi për masat disiplinore”.

Legjislacioni në fuqi, konkretisht Ligji për Statusin ka parashikuar edhe mundësinë e komandimit të magjistratit, me pëlqimin e tij, në institucione të tjera brenda sistemit të drejtësisë, përfshirë këtu dhe në Gjykatën e Lartë, specifikuar në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”. Pika 1, e nenit 56, të Ligjit për Statusin ndër të tjera përcakton se: “1. Magjistrati mund të komandohet në Gjykatën e Lartë, ..., me mandat pesëvjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje, me kërkesë të institucionit ku komandohet magjistrati.”.

Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se pranë Gjykatës së Lartë funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor. Kjo Njësi ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë. Në pikën 4, të nenit 34, të këtij ligji, përcaktohet se: “Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarët ligjorë, në të cilën më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ndërkohë, në dispozitat e Ligjit për Statusin, konkretisht në nenet 54, 57 dhe 58, përcaktohet edhe procedura që duhet të ndjekë Këshilli, ashtu dhe institucionet e tjera në të cilat magjistrati mund të komandohet, në këto raste.

Sipas këtyre përcaktimeve ligjore, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur shkresa nr. {...} prot., datë 26.07.2023, protokolluar në Këshill në datën 27.07.2020, e Gjykatës së Lartë, me objekt: “Për plotësimin e organikës së Njesisë së Shërbimit Ligjor të Gjykatës së Lartë me ndihmësmagjistratë të rinj”. Përmes kësaj shkrese, Këshillit i është kërkuar komandimi i 2 (dy) magjistratëve gjyqtarë në pozicionin e “ndihmësmagjistratit” në Gjykatën e Lartë.

Në kërkesën e përcjellë më datë 14 shkurt 2024 Gjykata e Lartë parashtron ndër të tjera: që për arsye të ngarkesës ajo kërkon që të konsideronjmë me prioritet kërkesën e tyre për plotësimin e organikës së Njesisë së Shërbimit Ligjor jo tashmë me 2 por me 4

ndihmësmagjistratë dhe vijimin e procedurës së komandimit.

II. Vlerësimi i Komisionit

Për sa më lart, mbështetur në nenin 86, shkronja “d”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54, 56, 57 dhe 58 të Ligjit për Statusin, në pikën 4, të nenit 34, të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, mbi kërkesën e Gjykatës së Lartë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të shpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën e Lartë, për 4 (katër) pozicione të lira në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, propozim për të cilin është përgatitur Projektvendimi “Për hapjen e procedurës së komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Komisioni vlerëson se procedura të fillojë për hapjen e 4 (katër) pozicioneve. Ky konkluzion vjen duke mbajtur në konsideratë organikën aktuale nga struktura organizative në gjykatat e shkallëve të para (ku ne kemi mbajtur në konsideratë faktin që vetëm këtë vit kemi caktuar në tetor në pozicion 40 magjistratë të rinj dhe kemi mundësinë që nëpërmjet kësaj organike që kemi mund të përcjellim katër magjistratë për t’i çuar në Gjykatën e Lartë në pozicionin e ndihmësmagjistratit) sikundër përcaktohet edhe afati, dokumentacioni, kohëzgjatja, kushtet dhe kriteret preferenciale të kandidimit, sikurse jepet dhe informacioni për procedurën e komandimit, në përputhje me kërkesat e pikës 3, të nenit 54, të Ligjit për Statusin.

III. Struktura e projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 2 Krerë.

Kreu I i projektvendimit, pikat 1 dhe 2, bëjnë fjalë për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura, për komandim në Gjykatën e Lartë, për 4 (katër) pozicione të lira si “ndihmësmagjistrat”.

Në pikën e tretë, lidhur me afatin e paraqitjes së kërkesave parashikohet se Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është: opsioni i) 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit ose opsioni ii) që ne propozojmë deri në datën 01.03.2024, një datë fikse të caktuar në varësi të shqyrtimit nga

mblledhja plenare. Meqenëse ne po mblidhemi sot dhe vendimmarrjen do e marrim sot, ne propozojmë një datë fikse që është data 01.03.2024 (afati pesëmbëdhjetëditor).

Në pikën 4 të këtij Kreu, përcaktohen dokumentet që duhet të paraqesë kandidati që do aplikojë në këtë procedurë.

Këto dokumente përfshijnë:

a) Kërkesa për shprehjen e interesit për të kandiduar për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.

b) Jetëshkrimi, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail), ku të pasqyrohet, veç të tjerash, çdo e dhënë e mundshme në lidhje me kushtet dhe kriteret preferenciale të komandimit;

c) Fotokopje të kartës së identitetit;

ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, pika 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

dh) Vërtetim nga gjykata/gjykatat për specializimin në fushën administrative, civile ose

penale;

e) Lista e rezultateve të studimeve dhe karakteristika e Shkollës së Magjistraturës nëse disponohet;

ë) Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës për pjesëmarrjen në programin e formimit vazhdues dhe përfshirjen në veprimtaritë trajnuese si trajner, lehtësues, pjesëmarrës;

f) Certifikatë/dëshmi për gjuhën e huaj;

g) Pesë dokumente ligjore, vendime gjyqësore, artikuj apo botime shkencore në fushën e jurisprudencës ku të pasqyrohet njohja e jurisprudencës;

gj) Rekomandime si dhe çdo dokument tjetër për aftësitë organizative dhe të komunikimit, si dhe për të punuarit në grup;

h) Çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

Në pikën 5 të këtij Kreu, përcaktohet vendi i dorëzimit të dokumentacionit, që është pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në Kreun II të projektvendimit jepet informacion për kohëzgjatjen, kushtet, kriteret preferenciale dhe procedurën e komandimit.

Në pikën 6 të projektvendimit, përcaktohet se kohëzgjatja e komandimit është pesë vjet.

Në pikën 7 të tij, përcaktohet mundësia e përfundimit të komandimit përpara afatit të mësipërm, në këto raste:

- a) me kërkesë të gjyqtarit të komanduar, për shkaqe të justifikuara;
- b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit;
- c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore;
- ç) kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen;
- d) kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra;

Në vijim, në pikën 8 të projektvendimit listohen kushtet e komandimit, që janë: a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit; b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar; c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar; ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë: i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit; ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës; d) Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi; dh) kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, me anëtarët e Gjykatës së Lartë, kancelarin, anëtarët e tjerë të Njesisë së Shërbimit Ligjor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

Pasur parasysh kërkesën e Gjykatës së Lartë, duke pasur në konsideratë natyrën e pozicionit për të cilën kërkohet komandimi i gjyqtarëve, institucioni është shprehur se

preferon që kandidatët të plotësojnë disa kritere specifike preferenciale, duke u bazuar në një sërë treguesish. Për rrjedhojë, në pikën 9 të projektvendimit përcaktohen kriteret preferenciale të komandimit e më konkretisht:

- a) Përvoja profesionale dhe specializimi në fushën administrative, civile ose penale;
- b) Njohuri të jurisprudencës së gjykatave vendase dhe ndërkombëtare;
- c) Rezultate të mira në studime, si dhe performanca në programin e formimit fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës;
- ç) Njohuri të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;
- d) Aftësi të mira të shkrimit dhe të arsytimit ligjor;
- dh) Aftësi shumë të mira të komunikimit profesional dhe njerëzor.

Në pikën 10 të projektvendimit përcaktohet dokumentacioni që do të shërbejë për vlerësimin nga Këshilli të kushteve të kandidimit, duke parashikuar që Këshilli mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit.

Në pikën 11 të projektvendimit, përcaktohet procedura e komandimit.

Kështu, fillimisht, nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të kandidimit, bëhet verifikimi dhe vlerësimi i plotësimit të kushteve të komandimit nga kandidatët që do të aplikojnë. Në këtë rast, Komisioni përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat, në lidhje me qenien e komandimit në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, projekt-opinione këto që më pas shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinione e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Në këtë pikë të projektvendimit përcaktohet se Këshilli vendos përjashtimin e kandidatit nga komandimi kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit.

Sipas parashikimit të bërë në pikën 12 të projektvendimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell menjëherë për vlerësim Gjykatës së Lartë emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e komandimit për pozicionin e ndihmësmagjistratit, dokumentacionin

e paraqitur nga ata në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre.

Në pikën 13 të projektvendimit, përcaktohet vijimi i procedurës së komandimit, ku Gjykata e Lartë, pasi vlerëson aplikimet e kandidatëve sa i përket kriterëve preferenciale, i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor komandimin e magjistratit që ka përzgjedhur.

Më tej, sipas pikës 14 të projektvendimit, brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit, të kandidatit të përzgjedhur nga Gjykata e Lartë.

Në pikën e fundit të projektvendimit, pikën 15, rregullohet situata ligjore kur asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet e komandimit apo kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet dhe kërkohet të komandohet nga Gjykata e Lartë. Në këtë rast, pas njoftimit të Gjykatës së Lartë dhe mbi kërkesën e saj, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rishpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për pozicionin e “ndihmësmagjistratit” në Gjykatën e Lartë.

Së fundi, në projektvendim parashikohet hyrja në fuqi menjëherë e tij dhe botimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

Hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit Gjykatën e Lartë.

2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën e Lartë për 4 (katër) pozicione “ndihmësmagjistrat” në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë.

3. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim deri në datë 01.03.2024.

4. Kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

a) Kërkesa për shprehjen e interesit për të kandiduar për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë;

b) Jetëshkrimi, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail), ku të pasqyrohet, veç të tjerash, çdo e dhënë e mundshme në lidhje me kushtet dhe kriteret preferenciale të komandimit;

c) Fotokopje të kartës së identitetit;

ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale me anëtarët e Gjykatës së Lartë, kancelarin, apo anëtarët e tjerë të Njësisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë;

dh) Vërtetim nga gjykata/gjykatat për specializimin në fushën administrative, civile ose

penale;

e) Lista e rezultateve të studimeve dhe karakteristika e Shkollës së Magjistraturës

nëse disponohet;

e) Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës për pjesëmarrjen në programin e formimit vazhdues dhe përfshirjen në veprimtaritë trajnuese si trajner, lehtësues, pjesëmarrës;

f) certifikatë/dëshmi për gjuhën e huaj;

g) pesë dokumente ligjore, vendime gjyqësore, artikuj apo botime shkencore në fushën e jurisprudencës ku të pasqyrohet njohja e jurisprudencës;

gj) rekomandime si dhe çdo dokument tjetër për aftësitë organizative dhe të komunikimit, si dhe për të punuarit në grup;

h) çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

5. Dokumentacioni sipas pikës 4, i këtij vendimi, dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit

6. Kohëzgjatja e komandimit është 5 (pesë) vjet.

7. Kohëzgjatja e komandimit mund të përfundojë para afatit:

a) me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;

b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit;

c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore;

ç) kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen;

d) kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra;

8. Kushtet e komandimit janë:

a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;

b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;

c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;

ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë:

i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;

ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;

d) Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

dh) Kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, me anëtarët e Gjykatës së Lartë, kancelarin, anëtarët e tjerë të Njesisë së Shërbimit Ligjor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

9. Kriteret preferenciale të komandimit:

a) Përvoja profesionale dhe specializimi në fushën administrative, civile ose penale;

b) Njohuri të jurisprudencës së gjykatave vendase dhe ndërkombëtare;

c) Rezultate të mira në studime, si dhe performanca në programin e formimit fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës;

ç) Njohuri të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;

d) Aftësi të mira të shkrimit dhe të arsyetimit ligjor;

dh) Aftësi shumë të mira të komunikimit profesional dhe njerëzor

10. Për vlerësimin e kushteve të kandidimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes së tij personale të administruar pranë Këshillit.

11. Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të kandidimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli vendos përjashtimin e kandidatit nga komandimi kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor, i përcjell menjëherë për vlerësim Gjykatës së Lartë emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e komandimit për pozicionin e

ndihmësmagjistratit, dokumentacionin e paraqitur nga ata në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre.

13. Gjykata e Lartë vlerëson aplikimet e kandidatëve dhe i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor komandimin e magjistratit që ka përzgjedhur.

14. Brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit, të kandidatit të përzgjedhur nga Gjykata e Lartë.

15. Nëse asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet e komandimit ose kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet nga Gjykata e Lartë, pas njoftimit dhe mbi kërkesën e kësaj të fundit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rihap procedurën e komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.02.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.⁴

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:21 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Emona Muçi | (anëtare) |
| 4. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
4. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
5. *Arben Lila, përfaqësues i EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
7. *{...}, përfaqësuese e ILD-së.*
8. *Mimoza Koçiu, këshilltare për komunikimin dhe median në kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
9. *Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).*

RENDI I DITËS:

9. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates *znj. {...}* me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

(Zoti Kurushi largohet nga salla dhe nuk merr pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje.)

Ilir Rusi: Për më tej, për shkak edhe të orarit, po vazhdojmë me pikën 2 (i referohet rendit të ditës) të këtij rendi dite që ka të bëjë me zhvillimin e seancës

dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Ju bëj me dije paraprakisht që kemi një autorizim nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë nr. {...}, datë 15.02.2024 për të cilën ka autorizuar zonjën {...} me detyrë Inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor të filluar ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Gjithashtu po ditën e sotme është paraqitur një kërkesë për shtyrje nga zonja {...}, gjithashtu në këto momente është paraqitur edhe një raport mjekësor i cili do të vihet në dispozicion.

Në shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës nuk do të marrë pjesë anëtari z. Klodian Kurushi për shkak se ka deklaruar konfliktin e interesit në një seancë të mëparshme.

(Ftohen palët të futen në sallë. Futet në sallë përfaqësuesja e ILD-së, znj. {...}.)

Ilir Rusi: Sipas njoftimit të bërë, sot është caktuar zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Prezent është znj. {...} e cila me autorizimin nr.{...}, datë 15.02.2024 të ILD-së është autorizuar znj. {...} me detyrë Inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor të filluar ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Gjithashtu edhe magjistratja {...} ka marrë njoftim në lidhje me zhvillimin e kësaj seance dëgjimore, por ditën e sotme ka paraqitur një kërkesë për shtyrje e cila është protokolluar me nr. 662/5, datë 15.02.2024 dhe është vënë në dispozicion. Gjithashtu, po në këto momente në orën 12:53 të ditës së sotme ka njoftuar nëpunësi përkatës dhe ka

dërguar një raport mjekësor i cili ju është vënë në dispozicion “Tiranë, datë 14 shkurt 2024, Institucioni Shëndetësor, qendra Shëndetësore Selitë, Tiranë, nr. regj. {...}, sipas të cilit zonja {...} është e paaftë për punë më 14.02.2024 por është e aftë për punë më datë 17.02.2024”.

Për këto rrethana, të cilat janë paraqitur nga zonja {...} do doja një diskutim nga ana e përfaqësueses së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

{...}: Duke qenë që magjistratja {...} ka paraqitur një kërkesë për shtyrje të kësaj seance, bashkëngjitur edhe dokumentacionin, si dhe njoftimin që ILD-ja është njoftuar dje në lidhje me disa kërkesa për dokumentacion të kësaj magjistratë, ILD është plotësisht dakord për shtyrjen e kësaj seance dhe vendosjen e një date tjetër.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}!

Mund të largoheni që Këshilli të vazhdojë me diskutime dhe më pas t’ju komunikojë vendimmarrjen përkatëse.

(Del nga salla përfaqësuesja e ILD-së, znj. {...}, si dhe palë të tjera të pranishme në sallë.)

Ilir Rusi: Atëherë, si relator i çështjes, ju janë vënë në dispozicion disa akte që kanë të bëjnë me komunikimin që kemi pasur me institucione të treta mbi vënien në dispozicion të vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Apelit të Posaçëm, nëse është bërë rekurs apo jo, dhe një kërkesë nëse është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë dhe ka bërë kërkesë për pezullim. Deri dje kishin ardhur përgjigje, ku nuk ishte arsyetuar vendimi dhe nuk kishte bërë kërkesë për pezullim vendimi në Gjykatën e Lartë apo një rekurs. Ndërkohë që ditën e sotme u bëra me dije që ka ardhur vendimi i arsyetuar nga Gjykata e Apelit të Posaçëm. Njëkohësisht u bëra me dije dhe për një kërkesë rishtazi që ishte kërkesa për shtyrje dhe njëkohësisht edhe raporti mjekësor.

Gjithashtu, po në datë 12, magjistratja {...} ka bërë një kërkesë për të vënë në dispozicion dosjen e procedimit disiplinor të cilën ka kërkuar t’i komunikohet në dy

rrugë, në rrugë postare ose të njoftohet nëpërmjet numrit të telefonit të vënë në dispozicion nga vetë magjistratja {...} për ta marrë dosjen fizikisht.

Në datë 13, ditë të martë janë kryer procedurat përkatëse dhe i është komunikuar znj. {...} që dosja është gati për t'u paraqitur por nuk është paraqitur për shkak sepse në ato momente ndodhej në një fatkeqësi.

Në këto rrethana i është komunikuar nëpërmjet po SMS-ve fakti që dosja do t'i vihej në dispozicion në adresën e banimit përkatës, të cilin ajo ka deklaruar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të dhëna të marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Pra duke marrë në konsideratë edhe kërkesën për shtyrje, prezumohet fakti që dosja ende nuk është marrë në dispozicion nga ana e magjistrates {...}.

Njëkohësisht me këtë kërkesë për shtyrje të cilën kërkon dosjen për të bërë një mbrojtje sa më efektive, kohë më parë ju janë paraqitur edhe kërkesat e saj procedurale, dy kërkesat, datë 24 janar 2024 dhe datë 9 shkurt 2024, kërkesë për pezullimin e këtij procedimi deri në përfundimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje në Gjykatën e Lartë, në eventualitet të bërjes së rekursit nga ana e saj. Pengesë për mosbërjen e rekursit ka qenë mungesa e vendimit të arsyetuar , -sipas pretendimeve të saj, -gjë të cilën sot ju bëj me dije që Gjykata e Apelit të Posaçëm na ka vënë në dispozicion vendimin e arsyetuar dhe prezumohet që edhe magjistratja {...} ta vërë në dispozicion në kohë të arsyeshme.

Paralelisht me këtë, meqenëse në momentet e fundit dhe para zhvillimit të kësaj seance dëgjimore të orës 13:00, në orën 12:53, nëpërmjet nëpunësit e telefonit të tij është përcjellë një raport mjekësor, sipas së cilës zonja {...} është e paaftë sot, nesër, e pasnesër dhe është e aftë më datë 17 shkurt (lëshuar nga qendra shëndetësore përkatëse, të cilën jua kam vënë në dispozicion).

Duke marrë në konsideratë edhe parashtresat e Inspektorit që meqenëse janë këto rrethana objektive, ajo ishte dakord për shtyrjen e seancës.

Do ftoja kolegët nëse kanë ndonjë diskutim apo jo, para se të shprehem unë për mendimin tim.

Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Duke qenë se zonja {...} ka paraqitur një kërkesë për shtyrje për

arsyet që lidhen me gjendjen e saj shëndetësore, e vërtetuar kjo me një raport shëndetësor, unë vlerësoj se duhet të shtyhet seanca. Ndërsa, për sa i përket kërkesës për marrjen e provave apo për njoftimin e saj, siç është bërë edhe njoftimi të cilin zonja {...} e ka konfirmuar nëpërmjet kërkesës për shtyrje, që është bërë me dije fakti që nga ana e Këshillit ka marrë dijeni për shkresën për njoftimin e seancës dhe i është bërë me dije që të marrë kopjet e saj, dhe kjo e fundit ka paraqitur kërkesën për të marrë kopjen e dosjes, ashtu siç ka paraqitur kërkesën, t'i lihet përsëri një afat 5-ditor për të marrë kopjen e dosjes së saj dhe për t'u njohur me aktet, duke u paraqitur pranë Këshillit ashtu siç ka paraqitur edhe kërkesën për shtyrje duke u paraqitur pranë Këshillit.

Kështu që unë mendoj që njoftimi t'i bëhet në rrugë telefonike duke qenë që kjo e fundit ka pranuar që të njoftohet nëpërmjet telefonit të vënë në dispozicion, ashtu dhe një kopje në adresën që kjo e fundit e ka konfirmuar, duke i bërë me dije të drejtën për t'u paraqitur në Këshill për të marrë kopjen e dosjes e cila është bërë gati dhe kjo e fundit është vënë në dijeni të faktit se është bërë gati e gjithë dosja e ardhur nga ILD-ja.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Edhe për këto kërkesa procedurale të saj është bërë me dije edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për ato të ardhura deri në ditën e djeshme dhe për këto të sotmet, u vunë në dispozicion, për të cilat u konfirmuan nga përfaqësuesi përkatës.

Edhe unë si relator i kësaj çështjeje, për këto rrethana objektive propozoj shtyrjen e seancës dëgjimore për këtë procedim disiplinor dhe në referim të procedimit disiplinor që kemi dhe për efektivitet dhe menaxhim të kohës dhe për t'i dhënë një kohë të arsyeshme për t'u mbrojtur, propozoj që seanca dëgjimore e radhës të jetë në datën 29 shkurt 2024, ora 12:00. Dakord. Ka propozime të tjera?

Meqenëse nuk ka propozimet të tjera, kalojmë në votimin e propozimit përkatës.

Irena Plaku: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë ftohet përfaqësuesja e ILD-së, me qëllim që t'i komunikojmë vendimin përkatës.

(Hyn në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së, znj. {...}, si dhe palë të tjera të pranishme në sallë.)

Ilir Rusi: Në vijim të këtij procedimi disiplinor, Këshilli, duke marrë në konsideratë rrethanat objektive, rrethanat shëndetësore të cilat vërtetohen me raport mjekësor për shkak të paaftësisë së saj të përkohshme, propozimit të relatorit, vendosi që seanca dëgjimore e radhës të mbahet në datë 29 shkurt 2024, ora 12:00. Pra shtyrja e kësaj seance dëgjimore. Faleminderit!

(Del nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së, znj. {...}.)

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.02.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën Kushtetuese”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:21 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 9. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 4. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
- 5. Arben Lila, përfaqësues i EU4Justice (në sallë).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 7. Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën Kushtetuese”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

(Futet në sallë zoti Kurushi.)

Ilir Rusi: Zoti Kurushi është tashmë prezent në shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, që është pika 10, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën Kushtetuese” (*Rishpallje*), për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi.

Të nderuar kolegë, po ju parashtoj përpara jush relacionin e radhës që i referohet kërkesës së paraqitur nga Gjykata Kushtetuese me objekt miratimin e projektvendimit për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën Kushtetuese.

Legjislacioni në fuqi, konkretisht Ligji për Statusin ka parashikuar edhe mundësinë e komandimit të magjistratit, me pëlqimin e tij, në institucione të tjera brenda sistemit të drejtësisë, përfshirë këtu dhe në Gjykatën Kushtetuese, specifikuar në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”. Pika 1, e nenit 56, të Ligjit për Statusin përcakton se: “1. Magjistrati mund të komandohet në Gjykatën Kushtetuese, ..., me mandat pesëvjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje, me kërkesë të institucionit ku komandohet magjistrati.”.

Në Ligjin nr. 8577, datë 10.02.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, në Nenin 14 parashikohet se: “1. Pranë Gjykatës Kushtetuese funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila përbën bërthamën shkencore juridike të Gjykatës Kushtetuese. Ajo ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese duke përfshirë: përgatitjen e çështjeve për gjykim, dhënien e opinioneve ligjore dhe përgatitjen e kërkimeve shkencore për çështjet gjyqësore që janë për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese. 2. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarë ligjorë, të cilët emërohen nga Kryetari, nga radhët e juristëve që plotësojnë kriteret për të qenë gjyqtarë, prokurorë ose juristë me përvojë jo më pak se 10 vjet si lektorë të së drejtës, avokatë ose nëpunës të lartë të administratës publike. Jo më pak se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë emërohen nga radhët e magjistratëve.

Në këtë drejtim është e domosdoshme që një pjesë e këshilltarëve ligjorë të gjykatës të plotësohen nga radhët e ndihmësmagjistratëve ashtu sikurse e parashikon dispozita e mësipërme ligjore. Në këtë drejtim, është e domosdoshme pasja e një përvoje profesionale minimale sipas kriterëve të parashikuara në shkresën e paraqitur nga Gjykata Kushtetuese për rekrutimin në skemën e komandimit të ndihmësmagjistratëve që vijnë nga radha e magjistratëve. Përvoja profesionale të jetë jo më pak se një vit sikurse edhe

specializimi i tyre si në çështje të së drejtës së brendshme, ashtu edhe në çështjet e së drejtës ndërkombëtare. Për këto arsye është paraqitur fillimisht shkresa e datës 26.05.2023 e protokolluar në Këshill, me objekt kërkesë për komandimin e tre magistratëve në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën Kushtetuese në pozicionin e Këshilltarit ligjor.

Me vendimin nr. 381, datë 17.07.2023 ka vendosur: “1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën Kushtetuese. 2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën Kushtetuese për 3 (tre) pozicione “ndihmësmagjistratit” në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën Kushtetuese.” Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar data 31 korrik.

Erdhi në atë kohë një kërkesë nga një magistrat të cilin ne ia dërguam Gjykatës Kushtetuese më tej për të bërë vlerësimin e kriterëve specifike që i kërkonte Gjykata Kushtetuese në shkresën e saj.

Pas përfundimit të procedurës kandidati që aplikoi nuk u përzgjedh nga institucioni kërkues që ishte Gjykata Kushtetuese.

Më tej Gjykata Kushtetuese me shkresën nr.{...} prot., datë 19.01.2024, ka kërkuar edhe një herë rishpalljen e kërkesës për 2 (dy) vende në pozicionin e “ndihmësmagjistratit” në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën Kushtetuese.

II. Vlerësimi i Komisionit

Nëpërmjet kërkesës së mësipërme Gjykata Kushtetuese parashtron se: “...lutemi të vlerësoni kërkesën për rihapje të procedurës së komandimit të dy magistratëve në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese në pozicionin “këshilltar ligjor” sipas të njëjtave kriterë specifike dhe kohëzgjatje të komandimit të dërguara më parë...”

Në këtë pikë, ashtu sikundër unë e referova (nëse dhe kolegët janë dakord) për kriteret ligjore të komandimit, edhe në rastin e kandidaturave për ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë, vlejné të njëjtat kriterë ligjore. Baza ligjore janë nenet 53, 54, 56, 57 dhe 58 të Ligjit për Statusin, nenit 14/a, të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, dhe mbi kërkesën e Gjykatës Kushtetuese, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të rishpallë

kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën Kushtetuese, për 2 (dy) pozicione të lira në pozicionin e “këshilltarit ligjor”, propozim për të cilin është përgatitur projektvendimi “Për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën Kushtetuese”.

Komisioni vlerëson se procedura të fillojë për rishpalljen e 2 (dy) pozicioneve sipas kërkesës së institucionit kërkues si edhe në zbatim të pikës 15 të vendimit nr. 381, datë 17.07.2023 ku parashikohej se: “Nëse asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet e komandimit ose kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet nga Gjykata Kushtetuese, pas njoftimit dhe mbi kërkesën e kësaj të fundit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rihapë procedurën e komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën Kushtetuese”; ky konkluzion vjen duke mbajtur në konsideratë organikën aktuale dhe strukturën organizative në gjykatat e shkallëve të para pas emërimit të 40 magjistratëve që përfunduan Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023.

III. Struktura e projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 2 Krerë.

Kreu I i projektvendimit, pika 1 bën fjalë për rishpalljen e kërkesës për kandidatura, për komandim në Gjykatën Kushtetuese, për 3 (dy) pozicione të lira si “ndihmësmagjistrat /këshilltar ligjor”.

Në pikën e dytë, lidhur me afatin e paraqitjes së kërkesave, ne e kemi lënë në mënyrë opsionale, opsioni i) 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose opsioni ii) deri në datë 01.03.2024, pra një datë fikse të caktuar në varësi të shqyrtimit nga mbledhja plenare. Meqenëse ne mblidhemi sot më datë 15, afati i fundit 15-ditor, nëse do ta lëmë afatin 15 ditë, është data 01.03.2024.

Në pikën 3 të këtij Kreu, përcaktohen dokumentet që duhet të paraqesë kandidati që do aplikojë në këtë procedurë.

Këto dokumente janë:

a) Kërkesa për shprehjen e interesit për të kandiduar për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit /këshilltarit ligjor në Gjykatën Kushtetuese;

b) Jetëshkrimi, me të dhënat e plota të kontaktit ku të pasqyrohet, veç të tjerash, çdo e dhënë e mundshme në lidhje me kushtet dhe kriteret preferenciale të komandimit;

c) Fotokopje të kartës së identitetit;

ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, pika 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

dh) Vërtetim për përvojën profesionale minimale prej 1(një) viti si magjistrat profili gjyqtar në fushën e të drejtës përkatëse dhe vërtetim nga gjykata/gjykatat për specializimin në fushën administrative, civile ose penale;

e) Lista e rezultateve të studimeve dhe karakteristika e Shkollës së Magjistraturës nëse disponohet nga kandidatët;

ë) Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës për pjesëmarrjen në programin e formimit vazhdues dhe përfshirjen në veprimtaritë trajnuese si trajner, lehtësues, pjesëmarrës dhe veprimtari të tjera kualifikuese dhe trajnuese;

f) Certifikatë/dëshmi për gjuhën e huaj të Bashkimit Evropian;

g) Tre dokumente ligjore, vendime gjyqësore, artikuj apo botime shkencore në fushën e jurisprudencës ku të pasqyrohet njohja e jurisprudencës; specializimi në fushën kushtetuese dhe të drejtave të njeriut do të konsiderohet avantazh;

gj) Njohja e jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut dhe asaj ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut do të konsiderohet avantazh;

h) Rekomandime si dhe çdo dokument tjetër për aftësitë e komunikimit;

i) çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

Në pikën 4 të këtij Kreu, përcaktohet vendi i dorëzimit të dokumentacionit, që është pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në Kreun II të projektvendimit jepet informacion për kohëzgjatjen, kushtet, kriteret preferenciale dhe procedurën e komandimit.

Kështu, në pikën 5 të projektvendimit, përcaktohet se kohëzgjatja e komandimit

është 3 (tre) vjet, me të drejtë ripërtëritje.

Ndërsa në pikën 6 të tij, përcaktohet mundësia e përfundimit të komandimit përpara afatit të mësipërm, në këto raste:

- a) me kërkesë të gjyqtarit të komanduar, për shkaqe të justifikuara;
- b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit;
- c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore;
- ç) kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen;
- d) kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra.

Në vijim, në pikën 7 të projektvendimit listohen kushtet e komandimit, që janë: a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit; b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar; c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar; ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë: i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit; ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës; d) Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi; dh) kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, me anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, Sekretarin e Përgjithshëm, anëtarët e tjerë të Njësisë së Shërbimit Ligjor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

Pasur parasysh kërkesën e Gjykatës Kushtetuese, duke pasur në konsideratë natyrën e pozicionit për të cilën kërkohet komandimi i gjyqtarëve, institucioni është shprehur se preferon që kandidatët të plotësojnë disa kriteret specifike preferenciale, duke u bazuar në një sërë treguesish. Për rrjedhojë, në pikën 8 të projektvendimit përcaktohen kriteret preferenciale të komandimit e më konkretisht:

- a) Përvojë profesionale minimale prej 1 (një) viti dhe vërtetim nga gjykata/gjykatat për specializimin në fushën administrative, civile ose penale;
- b) Njohuri të jurisprudencës së gjykatave vendase dhe ndërkombëtare;
- c) Specializimi në fushën kushtetuese dhe të drejtave të njeriut do të konsiderohet

avantazh;

ç) Njohja e jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut dhe asaj ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut do të konsiderohet avantazh

d) Rezultate të mira në studime, si dhe performanca në programin e formimit fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës;

dh) Njohuri të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;

e) Aftësi të mira të shkrimit dhe të arsytimit ligjor;

ë) Aftësi shumë të mira të komunikimit me shkrim dhe me gojë.

Në pikën 9 të projektvendimit përcaktohet dokumentacioni që do të shërbejë për vlerësimin nga Këshilli të kushteve të kandidimit, duke parashikuar që Këshilli mbështetet në

dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit.

Në pikën 10 të projektvendimit, përcaktohet procedura e komandimit.

Kështu, fillimisht, nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të kandidimit, bëhet verifikimi dhe vlerësimi i plotësisht të kushteve të komandimit nga kandidatët që do të aplikojnë. Në këtë rast, Komisioni përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat, në lidhje me qenien e komandimit në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, projekt-opinione këto që më pas shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinione e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Në këtë pikë të projektvendimit përcaktohet se Këshilli vendos përjashtimin e kandidatit nga komandimi kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit.

Sipas parashikimit të bërë në pikën 11 të projektvendimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell menjëherë për vlerësim Gjykatës Kushtetuese emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e komandimit për pozicionin e ndihmësmagjistratit/këshilltarit ligjor, dokumentacionin e paraqitur nga ata në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre.

Në pikën 12 të projektvendimit, përcaktohet vijimi i procedurës së komandimit, ku Gjykata Kushtetuese, pasi vlerëson aplikimet e kandidatëve sa i përket kritereve preferenciale, i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor komandimin e magjistratit që ka përzgjedhur.

Më tej, sipas pikës 13 të projektvendimit, brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit/këshilltarit ligjor, të kandidatit të përzgjedhur nga Gjykata Kushtetuese.

Ndërkohë, në pikën e fundit të projektvendimit, pikën 14, rregullohet situata ligjore kur asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet e komandimit apo kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet dhe kërkohet të komandohet nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast, pas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese dhe mbi kërkesën e saj, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rishpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për pozicionin e “ndihmësmagjistratit” në Gjykatën Kushtetuese.

Së fundi, në projektvendim parashikohet hyrja në fuqi menjëherë e tij dhe botimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën Kushtetuese” – *Rishpallje e kërkesës.*

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi motamo sipas propozimeve të bëra nga ana e relatorit z. Kurushi dhe për efekt të kohës nuk po i lexoj edhe një herë ato çfarë u prezantuan si pjesë e këtij projektvendimi në momentin e parë të relatimit që tashmë është vendim.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.02.2024)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).⁵

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:21 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |

⁵ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
4. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
5. *Arben Lila, përfaqësues i EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Vijon çështja e fundit e rendit të ditës që ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Fjala i jepet relatorit z. Alban Toro i cili parashtron shkurtimisht se më datë 14.02.2024, pranë KLGJ-së, është regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, të Zëvendëskryetares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila kërkon disa gjyqtarë për 5 çështje (sipas tabelës bashkëlidhur

relacionit).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Më tej, propozimet e Komisionit lidhur me këtë çështje janë si vijon:

1. Për çështjen me numrin rendor 1-4 në tabelë, gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

2. Gjyqtarët për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçanta të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçantë, të jetë 9 (nëntë).

4. Për çështjen me numrin rendor 5 në tabelë, propozohet që duke qenë se është çështje e ndarë nga i njëjti procedim penal me atë të çështjes nr. 75 akti, dhe kërkohet plotësimi i trupit gjykues për seancë paraprake, në pajtim me parashikimin K.Pr.Penale, përkatësisht neni 332/1 ku për përcaktohet se: “Kërkesat për dërgimin për gjykim të çështjeve të ndara nga i njëjti procedim penal, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar”, do të caktohet gjyqtari i caktuar për gjykimin e kërkesës nr. 114, z. {...}.

Pra për 4 (katër) çështje, për të cilat kërkohet respektivisht në dy raste nga 3 gjyqtarë, në një rast 2 gjyqtarë dhe në një rast 1 gjyqtar, të përzgjidhen me short 9 të tillë, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart.

Për çështjen me numër rendor 5 në tabelë për të cilën vlejné parashikimet e ligjit procedural penal (neni 332/1 i K.Pr.Penale) të caktohet gjyqtari i përzgjedhur më parë

nga Këshilli si gjyqtar i seancës paraprake, z. {...}.

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit (përmenden gjyqtarët të cilët kanë pengesë ligjore).

Bashkëlidhur relacionit është edhe lista e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për t'iu nënshtruar shortit.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për kërkesën nr.298/3, gjyqtarja Luljeta Kole.

Për kërkesën nr.432, gjyqtarët Marçela Shehu dhe Gentian Marku.

Për kërkesën nr.434, gjyqtarët Eglantina Mikani relatores, Olkeda Lice dhe Entela Shedula anëtarë.

Për kërkesën nr.483, gjyqtarët Matilda Llangozi relatores, Albert Meça dhe Ilir Përdeda anëtarë.

Mbyllet procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor